

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
"Hidro clima AE" sh.p.k.



Sot më 27.06.2022, në Durrës, shtetasit të mëposhtëm:

Aldi Murataj, lindur në Tiranë, Shqipëri, në 09.06.1992, me Nr. Pasaportës BD3619540, lëshuar nga Ministria e Brendshme në datën 20.06.2022 dhe e vlefshme deri në datën 19.06.2032, me Nr. Personal J20609050R, banues në Tiranë, Shqipëri.

Erand Kadrimi, lindur në Durrës, Shqipëri, në 10.03.1993, mbajtës i letërnjoftimi Nr. 037508478, lëshuar nga Ministria e Brendshme në datën 29.07.2021 dhe e vlefshme deri në datën 28.07.2031, me Nr. Personal J30310096V, banues në Durrës, Shqipëri.

Bazuar në:

Kushtetutën e Shqipërisë;

Kodin Civil;

Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, kemi vendosur që, nëpërmjet këtij Akti Themelimi, të themelojmë shoqërinë

"Hidro clima AE" sh.p.k.

NENI 1

Shoqëria themelohet me emrin **"Hidro clima AE" sh.p.k.**, emër i cili do të pasqyrohet edhe në vulën zyrtare të shoqërisë. Shoqëria **"Hidro clima AE" sh.p.k.** mund të përdorë emrin **"Hidro clima AE" sh.p.k.** ose emrin tregtar **Hidroclima**. Këtu e më poshtë në këtë Akt Themelimi, shoqëria **"Hidro clima AE" sh.p.k.** do të referohet vetëm si shoqëria.


NENI 2

Selia e shoqërisë Lagjja Nr.4, Rruga Skenderbej, ZK 8514, nr.pasurie 2/106+1-2/2, Durrës.

NENI 3

3.1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë ose jashtë tij.

3.2. Me vendimarrjen e Asamblesë së Përgjithshme, shoqëria mund të themelojë degë ose zyra perfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë.



NENI 4

4.1. Kapitali themelues i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë, që përfaqësohet nga 2 (dy) kuota.

4.2. Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Aldi MURATAJ është zotërues i 1 kuote, me 50% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerë 50,000 lekë.

Erand KADRIMI është zotërues i 1 kuote, me 50% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerë 50,000 lekë.

4.3. Kuotat janë nominale dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.

4.4. Çdo kuotë përfaqëson të drejtën për një votë.

NENI 5

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, në përputhje me objektin, për një periudhë kohore pa afat, që fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me objektin e përcaktuar në këtë Akt Themelimi, bazuar në legjislacionin shqiptar si dhe në Statutin bashkëlidhur këtij Akt Themelimi.

NENI 7

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë, përfshirë dhe pa u limituar:

- Sherbime hidraulike, mekanike, aspirim, kondicionim, sisteme MKZ dhe ushtrimi i tregtisë me shumice e pakice i artikujve të ndryshëm industriale, pajisje e materiale të ndryshme hidraulike, mekanike, pajisje dhe makineri kondicionimi, aspirimi, ventilimi, pompa uji të gjitha llojeve, impiante teknologjike, tubacione dhe rekorderi të gjitha llojeve etj., dhe në përgjithësi çdo aktivitet plotësues; Kryerje e furnizimeve dhe instalime të impianteve elektro-mekanike dhe të pajisjeve teknike për aktivitetet që operojnë e kanë lidhje me ato të shoqërisë, ndertimeve civile, industriale etj.; Për të përmbushur qëllimin e saj, kompania ka të drejtë të kryejë çdo veprimtari tjetër që nuk bie në kundërshtim me sa më sipër dhe që konsiderohet e dobishme për të përmbushur qëllimin e veprimtarive të kompanisë.



NENI 8

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik dhe të drejtën për të ushtruar aktivitete si dhe për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime, vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 9

Organi drejtues më i lartë i shoqërisë është **Asambleja e Përgjithshme**, e cila operon në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe merr vendime, përfshirë dhe pa u limituar, në përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë, amendimin e Statutit, emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, likuidatorëve, Audituesve Ligjorë, mbikqyrjen e implementimit të politikave tregtare nga administratorët, themelimin e degëve të reja, miratimin e pasqyrave financiare dhe raportet e progresit të shoqërisë, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë si dhe çështje të tjera siç përcaktohen nga legjislacioni përkatës.

NENI 10

10.1. Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme.

10.2. Ne aktin e emërimit, përcaktohet edhe periudha e ushtrimit të funksionit, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 11

Administratori i shoqërisë është Z. Aldi Murataj, lindur në Tiranë, Shqipëri, në 09.06.1992, Nr pasaporte. BD3619540, lëshuar nga Ministria e Brendshme në datën 20.06.2022 dhe e vlefshme deri në datën 19.06.2032, me Nr. Personal J20609050R, banues në Tiranë, Shqipëri, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 12

Detajet në lidhje me menaxhimin e Kapitalit themelues, transferimin, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, menaxhimin administrativ të shoqërisë, balancat kontabël dhe financiare, falimentimin si dhe likuidimin etj., janë të përcaktuara qartësisht në Statutin e shoqërisë.

NENI 13

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 kopje në gjuhën shqipe me të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore dhe, pasi u lexua, kuptua dhe u miratua në parim dhe nen për nen

nga ortakët themelues të shoqërisë "Hidroclima" sh.p.k., nënshkruhet dhe hyn në fuqi me miratimin dhe pranimin e depozitimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "Hidro clima AE" sh.p.k.

MIRATIMI I KËTIJ AKT THEMELIMI Nga:

Z. Aldi Murataj

Aldi Murataj 

Z. Erand Kadrimi

Erand Kadrimi 

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE Durrës
NOTER JULED A. BEQIRAJ



V2022011520163986150

DATE 28/06/2022

NR REP 3702

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 28.06.2022, para meje Noter JULED A. BEQIRAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Durrës, me zyrë në adresën Durrës, NR.4, EGNATIA, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT: Aldi Murataj, atësia Daut, amësia Mirjeta, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në VORË, me adresë Repartit 03890081; Nd. 2; H. 1; Bërxullë; Domje; 1053; Vorë, lindur më 09/06/1992, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 028763399 dhe nr. personal J20609050R ,

NËNSHKRUES/IT: Erand Kadrimi, atësia Rexhep, amësia Lume, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Melek Kalamishi 00690521; Nd. 3; H. 1; Durrës; Durrës; 2003; Durrës, lindur më 10/03/1993, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037508478 dhe nr. personal J30310096V ,.

te cilet ne cilesine e ortakeve te shoqerise "Hidro clima AE" sh.p.k., me kerkuan vertetimin e nenshkrimit ne Akt Themelimi dhe Statuti i Shoqerise "Hidro clima AE" sh.p.k.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULED A. BEQIRAJ

